VENDIM
Nr.970, datë 2.7.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I 6 PUSEVE TË SHPIMIT, NË KONJAT, LUSHNJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i 6 puseve të shpimit, në Konjat, Lushnjë.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve, sh.a., Lushnjë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës, e cila paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 900 (nëntëqind) m^2, tokë/arë, me vlerë shpronësimi 501 300 (pesëqind e një mijë e treqind) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 102 000 (njëqind e dy mijë) lekë, të përballohen nga Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, sh.a., Lushnjë.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 501 300 (pesëqind e një mijë e treqind) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë "Fondi i shpronësimeve", e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë.
6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit korrik 2008.
7. Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, sh.a., Lushnjë, të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
8. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Proces regjistrimi", a "Plotësim dokumentacioni", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit dhe të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë subjektit kërkues, Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve, sh.a., Lushnjë.
9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, sh.a., Lushnjë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE TË CILËT DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË 6 PUSEVE TË SHPIMIT NË STACIONIN E POMPAVE KONJAT, LUSHNJË

Nr.	Emri	Sipërfaqja tokë/arë	Çmimi l/m^2	Vlera në lekë	Shënime
1.	Hamdi Isuf Nezha	225	637	143 325	Plotësim dokumentacioni
2.	Ilir Adem Qose	225	637	143 325	Plotësim

					dokumentacioni
3.	Bashkim Balil Duro	225	477	107 325	Plotësim dokumentacioni
4.	Kadri Hazhi Misiri	225	477	107 325	Plotësim dokumentacioni
	Shuma	900 m^2		501 300	

Vlera totale e shpronësimit është 501 300 (pesëqind e një mijë e treqind) lekë.